



---

PROCESVERBALI

---

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më 29.04.2015, me fillim në ora 10. Të pranishëm: anëtarët e Kuvendit, Nënkyryetarin komunës dhe drejtorët e drejtive, përfaqësuesit e OSBE-së, KFORIT, monitoruesin e KDI-së, përfaqësuesit e mediave.

Mbledhjen e ka kryesuar Nahit Elshani, Kryesues i Kuvendit dhe pasi ka përshëndetur të pranishmit, përbledhjen e sotme ka propozuar këtë:

**Rend Dite**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i draft rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i projekt Vendimit për shlyerjen e borxheve 50% për shfrytëzimin e pronës komunale (dyqane),
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shpalljen e interesit publik të pronës komunale për ndërtimin e stacionit të zjarrfikësve,
5. Shqyrtimi i kërkesës së banorëve të fshatit Xërëx për ndërtimin e hidrocentralit,
6. Shqyrtimi i kërkesës së komitetit për komunitete për emërimin e zëvendës kryetarit shtesë,
7. Formimi i komisionit ad-hoc për shqyrtimin e ankesave për bursa,
8. Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e Këshilltarëve,

**Florije Boshnjaku** – Ne kemi propozuar dhe kemi vodos që çdo herë kur të mbahen mbledhjet e KPF të sillen rekomandimet në Kuvend në mënyrë që mos kthehem i diskutojmë të njëjtat pika prapë në kuvend, unë nuk jam duke i parë këtu rekomandimet e as ndryshimet që janë nga KPF. Tek pika e 5 kemi kërkuar nga drejtoria përkatëse të na sillet një informatë me shkrim në lidhje me këtë lëndë. Përveç reagimit të fshatit është mirë të vije edhe një propozim nga ekzekutivi komunal se çka janë duke menduar ata dhe si ne mundë të vijmë deri tek kjo informatë dhe propozim. Po ashtu rreth pikës së 7 është dashur të na sillet propozim vendimi se sa anëtar janë të propozuar dhe cilat janë kompetencat e tyre.

**Fatmir Iska** – Unë dua të diskutoj rreth pikës 8 meqenëse ne po thuajse 95% nuk marrim përgjigje nga ana e ekzekutivit. Këtë porosi që unë sot e jap besoj se do t'i dërgohet edhe kryetarit të komunës i cili ka premtuar për transparencë dhe për llogaridhënie nga ana e drejtorëve për kuvendarët. Propozimi im është që pika e 8 pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve të vihet si pikë e 2 e rendit të ditës pas aprovimit të procesverbalit. Ky propozim është shumë i arsyeshëm për shkak se si pikë e fundit e rendit të ditës që është, zakonisht në fund mbesin shumë pak këshilltar e aq ma pak ekzekutivi komunal.

**Kryesuesi** – Në të kaluarën është tentuar që ta qitet si pikë e 2 por e kemi parë se është duke na mare shumë kohë dhe për atë arsy e është lanë si pik e fundit. Sidoqoftë unë propozimin e qesë në votim. Ndërsa sa i përket çështjes së rekomandimeve besoj se në të ardhmen do ta kemi parasysh këtë vërejtje. Rreth pikës së 5 besoj se drejtori e ka informatën. Sa i përket pikës së 7 nuk e di se pse kryetari i komisionit nuk e ka bërë këtë propozim vendim.

**Rasim Fazliu** – Pajtohem plotësisht me Fatmirin sepse me të vërtet pika 8 pyetjet dhe përgjigjet është duke humbur efektiv sepse edhe kuvendarët nuk po qëndrojnë në sallë deri në funde të mbledhjes por edhe drejtorët nuk po janë prezantë dhe kështu që shumë pyetjet që po nuk po kanë përgjigje, por është edhe problemi tjetër që edhe ne fillim të jetë kjo pikë do të zgjatet shumë dhe pikat me ma shumë rëndësi do të mbesin, është mirë që të diskutohet dhe të gjendet një zgjidhje e cila është ma e mirë. Kishte me qenë mirë që ne kuvendarët të pajtohemi që secili të ketë të drejtë të bëjë vetëm nga një pyetje dhe të shqyrtohet kjo në fillim si pikë e 2 e rendit të ditës.

**Kryesuesi** – Unë e qesë në votim propozimin e Fatmirit që pika e 8 pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve nga mbledhja e ardhshme të jetë si pikë e 2 e rendit të ditës: Me 3 vota kundër, 1 abstenim dhe të tjerët pro, aprovohet propozimi që nga mbledhja e ardhshme pika e pyetjet e këshilltarëve do të jetë pikë e 2 me kusht që të bëhen vetëm nga 1 pyetje nga ana e kuvendarëve.

**Kadri Dellova** – Ne jemi duke e mare një vendim që nuk është në përputhje me demokracinë dhe mund të ndodh që këshilltarët të kenë kërkesa për ma tepër pyetje, e me këtë i kufizohet këshilltarëve e drejta e të shprehurit dhe të menduarit. Po ashtu kam kritikë për drejtorët që nuk po janë prezantë në mbledhjet e Kuvendit, i vetmi drejtor Fehmi Hoxha është gjithmonë prezent.

**Kryesuesi** – E qes në aprovim rendin e ditës. Konstatoj se në mënyrë unanim është aprovuar rendi i ditës.

**1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.** A ka ndonjë vërejtje në procesverbal. E qes në aprovim procesverbalin. Konstatoj se në mënyrë unanim aprovohet.

**2.Shqyrtimi i draft Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale**, kjo rregullore është shqyrtuar në KPF, ka pas disa vërejtje dhe besoj se zyra ligjore i ka mare përsysh dhe ka bërë përmasimin e tyre.

**Fehmi Hoxha** – Kjo Rregullore ka pas disa vërejtje në KPF dhe të gjitha ato janë inkorporuar. Kjo është draft Rregullore dhe pas miratimit nga ana e juaj në Kuvend do të dal në diskutim publik dhe pas diskutimit publik prapë do të vije në Kuvend për miratim. Me hyrjen në fuqi të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba ka lindë nevoja të bëhet rregullorja e re për dhënien e lejeve mjedisore komunale, sepse neni 29 i Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba me nr. 01 1076 të datës 27.03.2015 e shfuqizon në tërësi Rregulloren e mëhershme për dhënien e lejes mjedisore komunale me nr.1849 të datës 30.04.2013. Rregullorja për dhënien e lejeve mjedisore ka për qëllim parandalimin e ndikimit negativ në mjedise që mund të shkaktohet nga subjektet publike apo private me rastin e realizimit të veprimeve dhe projekteve përkatëse të cilat munden të shkaktojnë çrrégullime në mjedis. Rregullorja në fjalë përcakton rregullat dhe procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin e ndikimit në mjedise dhe procedurat administrative gjatë procesit të vendimmarrjes nga autoritetet komunale për lëshimin e lejes mjedisore. Rregullorja ka gjithsej 27 nene dhe shtojcën me listën e aktiviteteve të bizneseve të specifikuara sipas veprimtarive që i nënshtrohen pagesës me rastin e marries së lejes mjedisore që është e ndarë në 6 grupe. Aplikimi për marrien e lejes mjedisore bëhet krahas zhvillimit të procedurave për marrien e lejes ndërtimore. Leja mjedisore komunale lëshohet për një periudhë prej 10 viteve duke u mbështetur tek neni 10 të Udhëzimit administrativ 10/2012 dhe mundësia e vazhdimit të lejes mjedisore parashihet në nenin 13 të po këtij Udhëzimi administrativ.

**Florije Boshnjaku** – Ne duhet të marrim vendim që kjo rregullore të del në debat publik dhe të jepen vërejtjet dhe sugjerimet e pastaj edhe ne do të japim kontributin tonë. Një pyetje për drejtorin, ne i kemi dhënë vërejtjet tona në KPF por kjo rregullore nuk ka ndryshime është e njëjtë si në KPF. Kam edhe një pyetje tjetër për drejtorin, tek grupi i 6 janë të liruar nga pagesa projektet publike, e pyes drejtorin a është procedurë e njëjtë për të mare leje mjedisore si personat fizikë edhe personat juridikë. Pyetja tjetër është objektet që ndërtohen në tërë komunë tonë, a duhet të nxjerrin të gjithë lejet mjedisore apo ka përjashtime për ata që janë jashtë vendbanimeve.

**Fehmi Hoxha** – Procedura është e njëjtë për të gjithë, pra nuk është e specifikuar vetëm pjesa urbane ose jo urbane, pas miratimit nga ana e juaj dhe hartën zonale që jemi në proces komplet do të shkojë sepse ligji nuk e ndan pjesën urbane dhe pjesën rurale për leje mjedisore.

**Kadri Dellova** – Kam disa vërejtje tek grupi i 3 që është 150 € për impiantet për rritjen e bagëtive, ndërsa grupi i 4 për servisët 100 €. Ne jemi dëshmitar se të gjitha auto servisat i djegin gomat dhe ato janë shumë të dëmshme, pra si mundë të jetë më e dëmshme ai që rrit dele dhe begati se sa një servis. Rritja e bagëtisë ma tepër është bio se sa e dëmshme për ambientin.

**Fatmir Iska** – Tek neni 8 komisioni profesional për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedise pika 3 duhet të jetë pika 2 dhe lidhet me nenin 9; tek afatet për miratim pika 1 po thuajse është e njëjtë dhe krijon pastaj një huti në zbatim të kësaj rregullore dhe besoj se kjo duhet të formulohet dhe të bëhet një nen e jo 2 nene, sepse kanë kuptimin e njëjtë. Ndërsa neni 10 në rast të aksidentit në procesin teknologjik duhet që të parashihen shpenzimet se kush i mbulon, subjekti afarist apo komuna, sepse nesër mundë të zhvillohet konflikti administrativ në procedurë gjyqisore dhe të kemi paqartësi në këtë drejtim. Po ashtu tek neni 25 ku thotë: ne rast të mos harmonizimit të dispozitave të kësaj rregullore me LVI apo Ligjit për vlerësimin dhe ndikimin në mjedise si dhe akteve tjera të pushtetit qendor ose raste të tjera kur ka zbrazëtira juridike në këtë rregullore, drejtpërsëdrejti vlejnë dispozitat e LVL ose dispozitat e ligjit për vlerësimin ne mjedise dhe akteve tjera të pushtetit qendor që rregullon çështjet lëndore deri në harmonizimin ligjorë të këtij akti. Pra, në vend se të bëhet ligji bazik se ku duhet të mbështetet kjo rregullore, ndërsa këtu thotë se bazën ja jep ligjit për vetëqeverisje lokale, ndërsa ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis ku thotë apo edhe ky. Kjo duhet të formulohet kështu: Në rast të kolizionit të dispozitave të kësaj rregullore me këtë ligj vlen Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe asgjë më tepër këtu nuk është dashtë të shtohet.

**Qazim Qeska** – Kjo Rregullore i ka disa dispozita që me të vërtet mundë të jenë të aplikueshme, por unë do të doja një sqarim nga zyra ligjore tek neni 24 - kompetencat që i lihen në rast kontesti gjykatake themelore si gjykata të përgjithshme, do të hasim nesër në kundërshtime. Kisha me thanë të shikohen dispozitat se kush është kompetent në Republikën e Kosovës të merret me çështjet administrative,gjykatake themelore apo gjykatake administrative. Lusë kolegët që të riformulojnë dhe t'i harmonizojnë nenen 24 dhe 25 dhe mos ti japim kompetencë gjykatake themelore sepse nuk është në kompetencën e tyre. Kompetente për këtë është Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative.

**Ejup Kabashi** – Unë pajtohem me vërejtjet që i dhanë kolegët Fatmiri dhe Qazimi, po ashtu edhe unë e kam një vërejtje tek shtojcat dhe aty nuk i shoh për marrien e lejes ata që merren me gurëthyes dhe zhavorr.

**Isak Hoti** – Sa i përket gurthyesve ne si komunë nuk jemi kompetent për dhënien e lejes ata marrin leje në ministri përkatëse. Ndërsa sa i përket nenit 24 edhe sot diku afér 42 lëndë janë në gjykatën themelore në Rahovec duke u shqyrtuar dhe pikërisht për atë e kemi paraparë, nuk e kemi paraparë vetëm ne por e kanë paraparë gjykatën themelore edhe shumë komuna tjera dhe jo gjykatën administrative sepse është vetëm një qendër në Prishtinë dhe pikërisht për atë gjitha komunat e kanë në gjykatat e nivelit lokal. Kurse neni 25 Ligji për vetëqeverisje lokale është

parë sepse neni 40 tek funksionimi i kuvendit i jep të gjitha kompetencat për rregullore dhe për çështje tjera që janë deleguar kompetencat. Në rast se ka ndonjë mos harmonizim bazë për ne është ligji i vetëqeverisjes lokale gjegjësisht neni 40 ku kuvendi e ka këtë të drejtë deri në harmonizimin e rregullores që të nxjerrë ndonjë vendim paraprak.

**Rasim Fazliu** – Neni 26 i cili thotë : me hyrje në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja për dhënen e lejes mjedisore komunale, dhe propozimi im është se është dashur t'na bini njëherë rregulloren e vjetër dhe të na tregohet në mënyrë të detajuar se çka po ndryshohet.

**Selim Duraku** – Tek neni 17 te dispozitat ndëshkuese kam një propozim që gjobat deri në 5.000 € janë shumë të mëdha dhe unë propozoj që të zvogëlohen nëse dëshirojmë të ndihmojmë mjedisin dhe të jenë prej 500 € - 1.000 €. **Kryesuesi** – Gjobat nuk janë për ti dënuar qytetarët, gjobat janë që t'i vedisojmë qytetarët që mos ta shkelin ligjin dhe sa ma të larta që të jenë do të kenë efekt ma të madh.

**Ejup Kabashi** – Mua më duken se shuma që është caktuar për gjoba është pak dhe unë kisha me propozu që të rritet më shumë dhe në atë mënyrë do të vedit qytetari që mos ta ndot ambientin.

**Bahtjar Hoti** – Në rregullore është shumë mirë e specifikuar se çfarë dokumentacioni duhet të kompletohet, dhe ai dokumentacion nënkuption në vete edhe ekspertë të ndryshëm nga mbrojtja e mjedisit. Kishte me qenë mirë për opinion me pas një fushatë sensibilizuese që të ketë ndikim edhe tek opinioni që ti ndalojë këto aktivitete, që mos ta ndotin mjedisin, ndërsa sa i përket bizneseve me kompletimin e dokumentacionit në bazë të kritereve që janë të parapara këtu, ai nuk do të ketë mundësi të shkelë dhe të ikë nga mbrojtja e mjedisit. Sa i përket gjobave ndoshta janë Besnik Hoti – Këto gjoba duhet të jenë sa ma të vogla, sepse 5.000 € nuk ka asnë biznes sot ti paguaj.

**Qazim Qeska** – Po kthehem prapë tek neni 24, nëse ja refuzon organi kompetent lejen një subjekti juridik ose fizik ku duhet ai të ankohet, dhe unë besoj se gjykatat komunale janë in kompetente. Sa i përket dispozitave ndëshkimore këto gjoba janë vetëm për ato subjekte që japid të dhëna të pa sakta. Pyetja ime është ata që nuk pajisen me leje ose që nuk i përbahen lejeve a do të gjobiten, ose kjo është e dhënë vetëm për një fakt, pra do të ndëshkohen vetëm ata që japid të dhëna të pa sakta. Dua ta di se çka do të ndodhë me ata që nuk i përbahen rregullave përmarrje të lejes.

**Nënkyetari** – Të gjitha propozimet e KPF janë të inkorporuara, por ja që sot me anë të diskutimeve dhe studimit nga ana e juaj për këtë rregullore, janë shfaqur edhe gjërat që kanë vend për diskutim dhe besoj se është mirë që diskutohet. Propozimi i Qazim Qeskës besoj se është më vend sepse lënda shkon në një gjykatë, nuk po them in kompetente por është një gjykatë tjeter që merret më këto raste. Është dashur të shtohet edhe kjo pjesë: të gjitha lëndët të cilat nuk janë pajisur me leje, pala ka të drejtë të ushtrojë ankesë tek gjykatë kompetente për këto çështje. Ndërsa tek neni 25 keni mundur shumë ma shkurt ta përkufizoni, pra keni mundur të thoni vetëm vlejnë dispozitat që janë paraparë në ligjet dhe pa i përmendë këto tjera. Unë kam një vërejtje tek neni 18 sepse për mu është e kundërtë e asaj se çka është shkruar aty, sepse sipas kësaj ma e lehtë është të mos jesh i pajisur me leje mjedisore dhe dënohesh 250 € - 500 €, ndërsa ai që është i pajisur me leje mjedisore mirëpo nuk i është përbajtur asaj dënohet me 500 € - 5.000 €.

**Fehmi Hoxha** – Besoj se të gjitha këto vërejtje kanë qenë të arsyeshme dhe po ashtu do të kemi edhe disa vërejtje gjatë diskutimit publikë dhe që të gjitha do të inkorporohen dhe në fund do të del një rregullore e mirë. Sa i përket nenit 17,18 janë të inkorporuar këto dispozita ndëshkuese, të gjitha lëndët i kthehen gjykatës. Unë nuk e di cilës gjykatë, administrative apo themelore sepse nuk jam juristë. Në rregulloren e 2013 nuk kanë qenë të paraparë dispozitat ndëshkuese, mendoj se neni 25 e rregullon që ne të kemi dispozitat ndëshkuese, normal me anë të miratimit nga ana e juaj. ekzistojnë 2 shkallë nëse ne e refuzojmë atëherë shkalla e 2 është MMPH për ankesa.

**Kryesuesi** – E qes në aprosim kush është për vënienë në debat publikë të kësaj rregullore: Konstatoj që në mënyrë unanim është aprovuar Vendimi përvienë në debat publikë të rregullores në fjalë.

**3. Shqyrtimi dhe aprovimi i projekt Vendimit për shlyerjen e borxheve 50% për shfrytëzimin e pronës komunale (dyqane), po ashtu edhe ky propozim vendim është shqyrtuar ne KPF, ku ka pas disa sugjerime dhe besoj se drejtori i ka marrë parasysh dhe i ka inkorporuar në propozim vendim.**

**Avdullah Kryeziu** – Propozimi i kryetarit ka kaluar në KPF me disa vërejte dhe disa sugjerime që janë dhanë në KPF por edhe në mbledhjen e kaluar të asamblesë komunale dhe të gjitha janë marrë parasysh. Ky vendim është në interes të gjitha bizneseve, po ashtu do të kemi edhe propozim vendime të tjera edhe për biznese që janë prodhuese. Komuna nuk ka fond të posaçëm për t'i ndihmuar bizneset dhe kemi menduar që ti ndihmojmë në kësot forma pra me shlyerje të borxheve 50%, po ashtu edhe ata që e kane kryer të gjitha obligimet ndaj komunës edhe për ta do e gjemë një formë për ti ndihmuar.

**Përparim Krasniqi** – Ky vendim i ka 2 anë pozitive dhe 2 anë negative. E para është çka do të bëhet me ato kompani që i kanë kryer të gjitha obligimet ndaj komunës, mos do të jetë diskriminues ndaj tyre ky vendim, dhe tjetra është nëse këto kompani e shlyen borgjin prej 50%, po çka do të bëhet nëse të njëjtat kompani pas 5 ose 10 vite nuk i kryen borxhin ndaj komunës dhe prapë do të vjen e njëjtë situatë ku do të kërkojnë shlyerjen e borxhit. Kisha kërkuar që të bëhet një strategji pak ma serioze për këto kompani dhe ti jepet një afat pak ma i gjatë në atë mënyrë ata të mund ti kryejnë të gjitha obligimet.

**Kryesuesi** - Ky vendim ka të bëjë vetëm me dyqanet e vogla që janë pronë e komunës, në të ardhmen inkasimin e borxhit do ta bëjmë përmes përbartuesit privat.

**Ejup Kabashi** - Afati kohor që i është dhënë prej 3 muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ka kompani të cilat kanë krijuar borxhe të mëdha dhe deri më tanë nuk kanë mundur ti shlyen borxhet dhe nuk e di se a do të mundur ti kryen për këtë afat 3 mujorë, sepse shuma që kanë borxh është e madhe. Prandaj unë kërkoj që ky propozim për shlyerje të borxhit prej 50% duhet të aprovohet nga ana e kuvendarëve, për arsy që t'i krijojmë bizneseve që në të ardhmen te jenë pagues të rregullt.

**Mirjeta Krasniqi** - Propozoj që afati kohor të jetë 3 – 6 muaj për arsy se disa borxhlinj kanë një borxh më të madh për ta paguar dhe afati prej 3 muajsh është shumë i shkurtër.

**Selim Duraku** - E shoh qe rekondimet që i kemi dhanë në KPF janë përfshirë në këtë vendim dhe ne si LDK jemi pro këtij vendimi.

**Rukije Krasniqi** - Ky propozim vendim është një vendim i vjetër që është dukë u përsëritur që nga viti 2008, shumica janë po këta biznese të cilat kanë pasur deri në 70.000 € borxh komunës dhe ju kanë falur gjysma. Ky propozim vendim është ma tepër diskriminues për ato biznese që janë të rregulla dhe inkurajues për ata që nuk paguajnë. Po shoh që është një problem tjetër dhe shqetësim tjetër në politikat qeveritare që në mënyrë selektive ju qepen disa bizneseve me motive politike dhe bëjnë lëshime që nuk janë të arsyeshme.

**Azbi Gashi** - Ne jemi këtu për ti ndihmuar bizneseve e jo për të ju ndihmuar disa individëve që janë të lidhur me pushtetin dhe nuk janë duke bërë pagesa dhe në fund kërkojnë që të i shlyhen borxhet prej 50 %, prandaj ne jemi kundra këtij vendimi.

**Bahtjar Hoti** - Ky vendim a është në përputhje me vendimin që është marrë nga Ministrisë e financave, nëse jo komuna duhet ti mendoj mirë disa politika konvencionale për mbledhjen e borxheve përmes një programimi afatgjatë, dhe të bëje një analizë atyre inkasimeve që janë bërë e pastaj të filloj me një ri programim të dytë me ata borxhi që nuk kanë mundur ti inkasoj, ndërsa falja e borxhit duhet të jetë opsjon i fundit.

**Kryesuesi** – Unë kam kërkuar edhe në KPF që ata të cilat kanë qenë pagues të rregullt të lirohen nga qiraja për 1 vit, mirépo ne jemi në fazën e vlerësimit të ankandit, nuk mundemi tash të bëjmë ketë, por besoj se në të ardhmen do ta bëjmë edhe këtë vendim që të lirohen për 1 vit nga qiraja.

**Rexhep Oruqi** – Unë në parim pajtohem dhe jam pro këtij vendimi, sepse në rend të parë çdo vendim që ka të bëjë më biznese duhet të ketë një efekt ekonomik dhe do të merret si rrëthanë lehtësuese për stimulim të mëtutjeshëm të zhvillimit të bizneseve. Në parim çdo amnisti e borxhit përfshin kategoritë e caktuara. Ne kemi edhe kategori të tjera të bizneseve që nuk janë të përfshira në këtë vendim. Mendoj se nëse dëshirojmë të stimulojmë biznesin komunal vendimi duhet të jetë ma gjithë përfshirës. Po ashtu duhet të caktohen disa kritere, se cilat janë ato kritere që jemi duke i falur ne borxhin se në çfarë gjendje janë ato biznese që jemi duke ju falur borxhin.

**Ejup Kabashi** – Unë nuk jam duke u pajtuar me Rexhepin sepse ne nuk jemi duke debatuar për biznese që janë duke operuar këtu por këtu kemi të bëjmë vetëm me faljen e borxhit që ka të bëjë ndaj komunës si qira.

**Rexhep Oruqi** – Unë nuk i përmenda bizneset të cilat nuk janë qiramarrës, unë isha duke folur pikërisht për bizneset që janë duke e shfrytëzuar pronën komunale.

**Kryesuesi** – Bizneset që i kanë marrë pronat komunale me ankand publikë do të jetë një vendim tjetër, ndërsa tanë kemi të bëjmë vetëm me këto biznese që i ka dhënë komuna me qira.

**Afrim Limani** – Unë e përshtendes këtë vendim dhe jam pro këtij vendimi, po ashtu konsideroj se ky vendim ka karakter të dyfishtë sepse jo vetëm që i përkrah bizneset por karakteri tjetër është se ky vendim është në interes të komunës. Pse e them këtë, sepse komuna e ka vështirë që ti inkasoj borxhet, por me shlyerjen 50 % të borxheve po realizon një pjesë prej 50 % të këtyre borxheve që realisht nuk kishte mundur ti realizoj kurrë. Ne duhet që të gjejmë një model që ti përkrahim ata të cilët kanë qenë pagues të rregullt.

**Fatmir Iska** – Kam një kërkesë për drejtorin, pasqyrën e këtyre borxhlive të na bie për 6 mujorin e fundit në mënyrë që ta shohim se si ka shkuar pagesa gjatë këtyre 6 muajt e fundit nga këta borxhi që i kemi. Pyetja ime është nëse nuk fitohet ankandi nga këta qiramarrës që i kemi këtu në listë çka do të bëhet me ta. Po ashtu kemi diferençë të madhe të borxheve sepse dikujt i hiqen vetëm 225 €, dikujt 400 € ndërsa dikujt 25.000 €, ndërsa është diskutuar se edhe ata që kanë qenë pagues të rregullt do ti hiqet 1 vit qiraja. Sa është kjo e barabartë me këta borxhlinj që i kemi, ne jemi që ti ndihmohet bizneseve, por jo të jemi neglizhnët në inkasimin e këtyre borxheve dhe në të ardhmen mos ti lejojmë në grumbullimin e kësaj shume që është. Unë prapë e them që këta borxhlinj as mbas 3 muajve nuk do të arrijnë të paguajnë shumën e borxhit prej 50 %.

**Avdullah Kryeziu** – Përparimi ka të drejtë sepse ka konotacione edhe pozitive edhe negative, por ne e thamë që do te kujdesemi edhe për ata që kanë qene pagues të rregullt. Po ashtu pajtohem me disa që thanë se afati kohorë prej 3 muajve është i shkurt, dhe këtë shumë të borxhit unë e kam gjet kur kam ardhur si drejtor, ndërsa biznesi GANEX unë e them para jush që ai nuk ka paguar asnjë cent. Kam një propozim për ju që të shtohet në vendim që të bëhet ri programim për disa biznese që kanë borxhe të mëdha, sepse ndoshta dikush nuk do të ketë mundësi të paguaj për 3 muaj, ky ishte vetëm një propozim, ne mundemi me e lanë vendimin kështu si është.

**Bahtjar Hoti** – Në bazë të kalkulimit të metrave kator tek bizneset e tjera shihet që nuk kanë paguar asnjë cent, siç po shihet sipas metrave kator që i ka biznesi Ganex prej mbas lufte nuk paska paguar fare qira, po ashtu edhe disa biznese tjera.

**Kryesuesi** – E qes në aprosim Vendimin për falje të borxheve prej 50% bizneseve të cilat janë të cekura në vendim: 15 për, 3 kundër, 3 abstenim. Konstatoj që vendimi është aprovuar.

**4. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për shpalljen e interesit publik të pronës komunale për ndërtimin e stacionit të zjarrfikësve**, edhe ky propozim vendim është shqyrtuar në KPF dhe është marrë vendim që ti kalohet kuvendit për shqyrtim dhe aprovim.

**Kujtim Popaj** – Pëershëndetje për të gjithë, ka qenë nevojë e kahershme ndërrimi i destinacionit të stacionit të zjarrfikësve e cila funksionon në kuadër të drejtorisë për shpëtim dhe emergjencia, ky objekt parashihet të ndërtohet në një parcelë me sipërsfaqe 67 ari 10 m<sup>2</sup> me numër kadastral 8789/1 dhe gjendet në vendin e quajtur Kraishte në rrugën magjistrale Rahovec – Malishevë, ne si qeveri komunale kemi konstatuar që kjo parcelë i plotëson të gjitha kushtet për ngritjen e këtij objekti prandaj kërkjmë nga ju që të aprovoni këtë vendim.

**Ejup Kabashi** – Kam një pyetje për drejtorin, a është vetëm për ta legalizuar parcelën apo ka ndonjë projekt komuna për ngritjen e këtij objekti. Si do të sigurohen mjetet dhe sa do të kushtoj ky projekt, apo ka ndonjë donacion nga ministria ose ndonjë organizatë nga jashtë, kishte qenë mirë të na shpjegoni pak ma detaishtë.

**Selim Duraku** – Ka qenë nevojë e kahershme për ndarjen e një parcele për zjarrfikësit, unë e përshëndesë këtë vendim dhe jam pro. Sa jam i informuar është një donacion dhe po ashtu është dhuruar një veturë për shërbimet e zjarrfikësve nga donatorët.

**Rukije Krasniqi** – Mendoj se është një propozim shumë me vend, sepse objekti i tanishëm ku është ka një hapësirë shumë të vogël. Unë jam pro këtij vendimi.

**Kryesuesi** – E qesë në aprovim propozim vendimin: Konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar propozim Vendimi për shpalljen e interesit publik të pronës komunale për ndërtimin e stacionit të zjarrfikësve, pika e radhës është:

##### **5. Shqyrtimi i kërkësës së banorëve të fshatit Xërxe për ndërtimin e hidrocentralit.**

**Kryesuesi** - Edhe kjo pikë e rendit të ditës ka kaluar në KPF, tani e keni marrë edhe një material me të dhëna konkrete nga drejtoria përkatëse. Kemi të bëjmë me një reagim të qytetarëve nga fshati Xërxe dhe fshatrave për rreth me pakënaqësinë që e kanë për dhënen e pëlqimit në parim nga ana e Dejtorisë për urbanizëm në vitin 2012 për ndërtimin e një hidrocentrali, i cili sipas qytetarëve ka pasoja në degradim të ambientit të lumbit Drini i bardhë. Sa i pashë para masat dhe befasohem se çfarë degradimi mund të ndodhë me ndërtimin e këtij hidrocentrali dhe nuk e di se si është dhënë pëlqimi në parim në 2012 pa u konsultuar me ekspertë të lamisë përkatëse. Sot nga ne si Kuvend kërkohet që të térhiqet pëlqimi në parim i vitit 2012, për arsyet e ka kaluar afati prej një muaji për térheqjen e ndonjë vendimi.

**Fehmi Hoxha** – Me datën 15.12 është bërë kërkesa e parë nga kjo kompani, në fillim ja kam lëshuar një konkluzë ku sipas ligjit është dashur ti përmbahet, ku i duhet certifikata e pronës jo ma vjetër se 6 muaj, mirëpo çështja kryesore dhe jo ligjore që i është dhënë është pëlqimi në parim. Më 27.11.2012 dhe ky pëlqim në parim është bazuar, ku thotë se nuk paraqet ndonjë pengesë për planin zhvillimor urban të komunës së Rahovecit. Komuna e Rahovecit asnjëherë nuk ka pasur plan zhvillimor urban dhe as sot nuk e ka. Pëlqimet në parim nuk janë dhënë vetëm në mandatin e kaluar, janë dhanë edhe ma herët e që është gabim që prej fillimi, sepse pëlqimi në parim nuk ekziston ngase nuk ka bazë ligjore. Unë kërkoj nga ju që të merrni një vendim për shfuqizimin e këtij pëlqimi në parim. Sa i përket hidrocentralit i keni të dhënët ku kërkohet që 4000 m të ndërtohet rruga në anën e majtë nga komuna e Rahovecit po ashtu edhe këtu duhet të merret një vendim për kompletë atë parcelë dhe për digën e cila do te jetë 110 m, nëse ju vendosni për dhënen e kësaj prone kompanisë.

**Azbi Gashi** – Ne pajtohemi plotësisht me reagimin e fshatrave për rreth dhe jemi kundër duke pasur përsysh se nuk ka shanse të ndërtohet diga në atë parcelë ku i është dhënë pëlqimi në parim.

**Florije Boshnjaku** – Në lidhje me këtë reagim të fshatrave unë shoh dy çështje të rëndësishme : fshati Xërxe ka dalë me reagim që mos të ndërtohet në atë vend ndërsa disa metra ma poshtë mund të ndërtohet ky hidrocentral. Pra, ky është reagim i fshatrave për rreth duhet ta keni të gjithë të çartë. Ndërsa tjetra është se Drejtoria e urbanizmit kërkon që pëlqimi në parim të shfuqizohet nga Kuvendi. Unë këtë pëlqim në parim nuk e kam parë dhe është e koton të flitet kështu, pëlqimi në parim ju është dhënë vetëm që të filloj procedura për rregullimin e dokumentacionit dhe nuk është vendos që t'ju jepet ai vend për ndërtimin e hidrocentralit. Ekziston zyra ligjore dhe të diskutohet se cila është procedura, sa e di unë deri sa një vendim nuk e merr kuvendi ai nuk mundet as ta shfuqizoj, veç asaj ai nuk është vendim por është pëlqim në parim për rregullimin e dokumentacionit.

**Marigona Berisha** – Unë jam kundër ndërtimit të këtij hidrocentrali tek tenda e lumbit Drini i bardhë, por jo vetëm unë por besoj se të gjithë janë kundër degradimit dhe shkatërrimit të tij. Unë mendoj se shqetësimet e banorëve janë me vend dhe se duhet të gjendet një vend më i përshtatshëm për ndërtimin e këtij hidrocentrali e jo të mos ndërtohet fare.

**Kadri Dellova** – Ne sot jemi duke diskutuar për një çështje shumë madhore dhe për një projekt kapital shumë gjigant. Ne të gjithë jemi adhurues të energjisë alternative, mirëpo shtrohet pyetja këto hidrocentralet që do të ndërtohen sot në Xërxe, unë kam informatë që edhe në Krushe të Madhe dhe të Vogël kanë bërë kërkesë në një gjatësi prej 10 km që të ndërtohen 4 hidrocentrale. Jam i bindur që do te dëmtohet edhe toka edhe mjedisë e sidomos peshqit. Shtroj pyetjen, mos këto hidrocentrale ose këto projekte janë vetëm për të konkurruar në bashkimin evropian. Unë jam kundra ndërtimit të këtyre hidrocentraleve.

**Bahtjar Hoti** – Sa i përket ndërtimit të hidrocentralit në bazë të analizave të ekspertëve që janë duke bërë edhe hidrocentrale tjera, mendoj se peshkun nuk do ta dëmtoj fare. Unë kam e kam parë një hidrocentral që e ka ndërtuar një shok dhe ai ja ka ndërtuar peshkut rrjedhën pra rrugën normale dhe ka marrë mirënjojje dhe Beni fit prej 3.000 € nga shoqatat për mbrojtjen e gjallesave ujore, pra, këtë punë e bëjnë ekspertët, ne nuk mund ta dimë se çka dëmtohet vetëm se flasim kot. Për ta laboruar ma gjerësish edhe për punën e tokës këtu nuk kemi të bëjmë me një ligj me ndikim mjedisor sikurse Radoniqi, këtu përmasat e gjerësisë, thellësisë dhe gjatësisë janë të përshkruar shumë mirë. Duhet të diskutojmë se çka do të fitoj komuna me këtë hidrocentral dhe unë mendoj se komuna do të fitoj shumë, ne duhet ti japid banorëve të Xërxe një përgjigje të drejtë.

**Rukije Krasniqi** – Lidhur me këtë unë kam informata nga banorët e fshatit Xërxe se ky petition është i ndikuar nga interesat e individive në biznes. Nuk është hera e parë që në komunën tonë të pengohen bizneset siç ishte fabrika e tullave në Fortesë, fabrika për riciklimin e mbeturinave për shkak të neglizhencës së kryetarit për ta pritur investorin suedez dhe ky investim ka qen rreth 43 milion € ka shkuar në Mitrovicë. Si jemi duke i ndjekur ne këto biznese, po më krijohet përshtypja sikurse jemi ne në Dubaj dhe nuk kemi nevojë më për zhvillim ekonomik.

**Fatmir Iska** – Kryesues ju thatë që ky pëlgim në parim të cilin ne e lexuam materialin që na e servoj drejtori ju kërkoni nga Kuvendi që ta bëjë shfuqizimin e këtij pëlgimi në parim. Unë e di që një organ i cili e merr një vendim po ai është i autorizuar që ta bëjë shfuqizimin e tij dhe assesi në këtë rrastë kuvendi komunal. Ne jemi për zhvillimin e komunës dhe për ndërtimin e hidrocentralit dhe tash aq më tepër kur mora informata që ky hidrocentral kurrfarë ndotje nuk do të bëjë, por vetëm të mira. Kam një pyetje këtë reagim që po e shqyrtojmë të banorëve të fshatit Xërxe a ju është dërguar ky edhe kuvendit komunal në Gjakovë dhe çfarë veprime kanë ndërmarr ata meqenëse lumin e ndajmë së bashku me komunën e Gjakovës. Pyetja tjetër është se a keni diskutuar me këtë investor potencial që nesër mund ta ndërtoj hidrocentralin. Unë ë lexova pëlgimin në parim dhe aty vetëm është e cekur mund të filloj vetëm inicimi i procedurave për rregullimin e dokumenteve dhe assesi dhënen në shfrytëzim të parcelave.

**Kryesuesi** – Kam një pyetje për drejtorin, këtu thotë se gjerësia do të jetë 110 m a do ti prek edhe pronat private, po ashtu dyshoj se krejt kjo është një lojë e këtij investitori që të fitoj ndonjë donacion prej Komisionit Evropian.

**Fehmi Hoxha** – Po filloj nga pyetja e fundit, 110 m është shtrati që menaxhohet nga MMPH - Departamenti i ujërave dhe pronën private nuk e prek fare, tjetra kërkesën që kanë bërë të ne është për leje urbanistike. Pyetja është pse është bërë kërkesa në Drejtorinë e urbanizmit, arsyesa është se toka që është pronë e komunës të ndërtohet komplekt edhe rruga edhe hidrocentrali. Me Gjakovën absolutisht nuk kanë kontaktuar fare. Personalisht kam biseduar edhe me kryetaren dhe ata nuk kanë kurrfarë kërkesë. Kompania është pajisur me çdo dokument që kerkohet sipas ligjit nga ministritë relevante. Është shumë e çartë që Kosova ka për obligim që 30 % të energjisë alternative të prodhojë, por ju jeni ata që vendosni se a duhet ti ndahet kësaj kompanie parcela apo jo.

**Besnik Hoti** – Prej urës së shenjtë sa është distanca e kësaj toke që kerkohet.

**Fehmi Hoxha** – Është diku afér 300 m, por banorët nuk e kanë caktuar se sa metra më poshtë të ndërtohet, vetëm kanë kërkuar që ndërtimi i hidrocentralit të jetë më poshtë.

**Rexhep Oruqi** – Unë dua ta di ekzekutivi çfarë qëndrimi ka në lidhje me ndërtimin e këtij hidrocentrali, e pastaj të na jepni një ide kuvendit se si të veprohet më tutje.

**Fehmi Hoxha** – Procedurat e ekzekutivit janë me propozim të kryetarit bëhet propozim vendimi që shkon në KPF, një gjë e tillë nuk është bërë e pastaj ky propozim vendim vjen në kuvend dhe shndërrohet në vendim nga ana e juaj, këto procedura nuk janë zhvilluar fare kur është marrë pëlgimi në parim.

**Nënkyetari** – Rexhepi e ngriti një çështje që duhet me të vërtet të diskutohet, por ne jemi të mangët edhe nga ana e informacioneve, nuk i kemi të gjitha nélendë. Sa sa më kujtohet më herët ka qenë një kërkesë që dikur ma vonë do ti vije në diskutim këtij kuvendi që afér 11 hektarë tokë duhet ti jepet në shfrytëzim dikujt dhe ky kuvend do të ballafaqohet me këtë kërkesë që kemi të bëjmë ne. Në momentin e caktuar është dhënë një pëlgim nga drejtori i drejtorisë përkatëse, për pëlgime të tilla kuvendi vendos e jo drejtori i drejtorisë.

**Kryesuesi** – Po ju lexojë këtë dokument të pëlgimit në parim : Drejtoria për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit duke u bazuar në rregullativën në fuqi dhe e orientuar në krijimin e kushteve ma të mira për zhvillimin e veprimitarive ekonomike pajtohet në parim që kompania Edel vais eng sh.p.k. nga Prishtina me përfaqësues ligjor Ismet Kelmendin të ndërmerr veprime procedurale për rregullimin e dokumentacionit investues për ndërtimin e hidrocentralit HC tek ura e shenjtë në komunën e Rahovecit, me kapacitet 6.5 megavat në njësi, ngastra me numër 1795 – 0 në vendin e quajtur lumi Drini i bardh dhe numër 1790 – 0 në vendin e quajtur rakita, të evidentuar me certifikatën të lëshuar me 20.11.2012 Xërxe. Kjo drejtori konsideron se ky projekt i planifikuar i Kompanisë nga

Prishtina nuk paraqet ndonjë pengës për planin zhvillimor urban të komunës së Rahovecit. Se pari ky kur është bazuar në rregullativa, por nuk është bazuar se në cilat rregullativa.

**Fatmir Iska** – Unë kisha me propozuar që drejtori të konsultohet me komunën e Gjakovës dhe të ndërmarrin veprime të përbashkëta nëse ka eventualisht edhe ndonjë kërkesë tjetër. Ju thatë se nuk i prek interesat e komunës së Gjakovës, atëherë pse e kemi në kryesinë e fshatrave një person me emrin Albert Quni dhe sa e di unë në komunën ton nuk ka me mbiemr Quni.

**Qazim Qeska** – Në çoftë se ai zotëria që e ka marrë pëlqimin ka avancuar mundet me paditë nesër komunën për shpenzimet që i ka bërë. Ju kërkoni nga ne që ta tërheqim këtë pëlqim në parim dhe thoni se ky pëlqim është në kundërshtim me rregullat pozitive me ligjin dhe aktet normative. Për mua është i pavlefshëm ky pëlqim në parim dhe nëse nga ne kërkohet që ta tërheqim ne do ta tërheqim, por frikësoshem mos do të ketë pasoja pastaj.

**Fehmi Hoxha** – Në atë pëlqim në parim që e lexoj kryesuesi është e çartë, pëlqimi bazohet në rregullativat në fuqi dhe rregullativat në fuqi nuk janë ato, pra bazohet në planin zhvillimor urban të vitit 2012 dhe ai plan nuk ka ekzistuar fare sikurse që nuk ekziston as tash.

**Kryesuesi** – E qesë në aprovim tërheqjen e pëlqimit në parim nga ana e kuvendit sipas kërkesës së Drejtorisë për urbanizëm për arsyen se nuk ekziston plani zhvillimor dhe tjetra është se dhënia e pëlqimit për pronën komunale është kompetencë dhe përgjegjësi e Kuvendit e jo e drejtorisë : 12 për, 1 kundër, 8 abstenime.:.

**6. Shqyrtimi i kërkesës së Komitetit për komunitete për emërimin e zëvendës kryetarit shtesë, Kryesuesi -** Kemi një propozim të Komitetit për komunitete, ku kërkojnë në bazë të Udhëzimit administrativ dhe Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale që Kuvendi i komunës të marrë një vendim për emërimin edhe të një zëvendës nënkyetari shtesë në komunën e Rahovecit. Me LVL për nënkyetar shtesë të komuniteteve mund të kenë komunat të cilat kanë popullsi pakicë mbi 10 %. Ne në komunën tonë nuk kemi këtë numër të komunitetit pakicë. Pastaj me udhëzimin administrativ neni 4 pika 2 thotë: në komunat ku komuniteti jo shumicë është ma pak se përqindja e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, emërimi i nënkyetarit të komunës nga radhët e komuniteteve jo shumicë mundë të bëhet pas marrjes së vendimit nga kuvendi i komunës. Ne e dimë se një nënkyetar i komunës i kushton 1.000 € në muaj dhe nuk e di se sa ka komoditet komuna jonë me këtë buxhet të varfér të ketë edhe një nënkyetar shtesë nga komuniteti jo shumicë, tjetra është se një nënkyetar për komunitet komuna e Rahovecit e ka pas në të kaluarën dhe fatkeqësisht ai nuk e ka luajtur rolin në integrimin e komuniteteve jo shumicë. Personi i cili kërkon të bëhet nënkyetar shtesë edhe pse nuk është zyrtarisht është personi i njëjtë që ka qenë edhe më par nënkyetar për komunitete.

**Fatmir Iska** – Unë kam vetëm disa pyetje? Në seancën e kaluar të KPF jemi informuar nga nënkyetari Haxhimustafa se do të propozohet personi i njëjtë i cili ka qen nënkyetar gjatë mandatit qeverisës 2008 – 2010. Pjetja ime është pse është shkarkuar ai në vitin 2010 nga ish kryetari i komunës Qazim Qeska, cila ka qenë performanca e këtij ish nënkyetari, sa është marrë ai me problemet, shqetësimet, nevojat dhe kërkesat e minoriteteve gjatë mandatit të tij të kaluar, dua ta di se cili është mendimi i qeverisë për këtë propozim të komitetit për komunitete dhe a ka mjete për pagesë për këtë nënkyetar shtesë. Për këtë pikë të rendit të ditës i ftojë këshilltarët e AAK-së që të lëshojnë sallën dhe për pikat e tjera të rendit të ditës do të kthehem për të diskutuar.

**Qazim Qeska** – Nënkyetari në mandatin 2008-2009 Bojan Nikallamiq e ka emëruar Kuvendi i komunës së Rahovecit dhe unë si kryetar e kam pranuar, por shkarkimi i tij nuk ka qenë për shkak të performancës së dobët por pas bisedave të gjata që kam pas me Piter Fejtin i kam thanë që ne në komunën e Rahovecit nuk kemi nevojë për nënkyetar shtesë, por nëse e paguani ju ne do e mbajmë sepse ne si komunë nuk kemi mundësi buxhetore ta paguajmë dhe ligji nuk na ngarkon ndërsa udhëzimi administrativ atëherë fare nuk ka ekzistuar. Përgjigja e Piter Fejtit ka qenë që edhe 2 muaj ta paguajmë ne, ne si komunë e kemi mbajtur edhe 2 muaj kur kanë kaluar 2 muaj e kam lajmëruar Piter Fejtin dhe më ka than që ata nuk kanë mundësi dhe mund të bësh çka të duash, pastaj unë e kam shkarkuar pra arsyaja kryesore e shkarkimit të Bojan Nikallamiq ka qenë mungesa e buxhetit.

**Nënkyetari** – Nuk kemi nevojë shumë me e debatuar këtë pikë, kur nuk donë dikush të merr përgjegjësinë dhe kinse është ma katolik se papa e lëshojnë seancën për ti ja lënë përgjegjësin dikujt tjetër. Propozimi është shumi qartë dhe nuk është i sodit por i 2014 ju është drejtuar edhe kryetarit edhe kuvendit. Nënkyetari për komunitet ekskluzivisht emërohet nga votat e kuvendarëve. Këtu nuk kemi të bëjmë me emra por qartë thotë se a ekziston mundësia për emërimin e një nënkyetari shtesë të komunitetit, e ju jeni ata që vendosni a ekziston apo nuk ekziston.

**Selim Duraku** – Në emër të grupit të LDK-së ne jemi kundër këtij propozimi, sepse mbas nenit 62 të Ligjit për vetëqeverisje lokale cekët që nënkyetari i dytë nga komunitetet mund të bëhet nëse është mbi 10%, ne në komunën ton nuk e kemi këtë përqindje.

**Bahtjar Hoti** – Është zgjatur shumë debati për një emër që nuk është përmend, ne nuk jemi duke ditur se a është ai keqpërdoruesi apo do të vije ndonjë keqpërdorues tjetër, megjithatë bazë ligjore nuk ka unë propozoj që të shkojmë në votim dhe mos ta zgjasim ma shumë.

**Arsim Kastrati** – Unë nuk e di pse e kanë shti si propozim kur është në kundërshtim me ligjin, po ashtu ne nuk jemi duke ditur se për kënd do të votojmë.

**Rasim Fazliu** - Edhe unë flas në emër të grupit të PDK-së po ashtu edhe ne jemi kundër këtij propozimi, arsyet janë cekur nga kolegët.

**Kryesuesi** - E qes në aprovim propozimin e komitetit për komunitete që Kuvendi i komunës ta ketë edhe një nënkyretar shtesë nga radhët e komuniteteve: Në mënyrë unanime është hedhur propozimi i Komitetit për komunitete.

**7. Formimi i komisionit ad-hoc për shqyrtimin e ankesave për bursa**, propozimi imë është që komisioni për bursa në mbledhjen e radhës të raportoj në kuvend për procesin e ndarjes së bursave, në mandatin e kaluar nuk kemi pas asnjë informacion se si ka shkuar procesi i ndarjes së bursave. Tek ky komision mendoj që të jenë 3 anëtar, 1 nga PDK, 1 nga LDK dhe 1 nga AAK dhe kisha kërkuar nga kryetarët e grupeve të dalin me propozime.

**Rasim Fazliu** - Ne nga grupi i PDK-së e propozojmë prof. Kadri Delloven.

**Sinan Bajraktari** - Ne nga grupi i LDK-së e propozojmë Arsim Kastratin.

**Artan Zenuni** - Ne nga grupi i AAK-së e propozojmë juristin Fatmir Iska.

**Kryesuesi** - E qes në aprovim kush është për këto emra të anëtarëve për komisionin ad-hoc për shqyrtimin e ankesave për bursa: konstatoj që në mënyrë unanime është zgjedhur komisioni ad-hoc për shqyrtimin e ankesave për bursa. Pika e radhës është:

#### 8.Pyetje dhe përgjigjet në pyetjet e Këshilltarëve.

**Ejup Kabashi** - Pyetja i drejtohet drejtorit për financa? ne e kemi një ligje për njohjen e statusit dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve, viktimate civile dhe familjeve të tyre nga lufta e fundit që ka qenë në Kosovë, unë kam një kërkesë për drejtorin e financave që të vije me një propozim në KPF për lirimin nga tatimi në pronë për këto kategori, sepse këtë e lejon ligji nen i 6 i cili thotë: Lirimin nga tatimi në pronë është e drejt të cilën e realizojnë familjet e dëshmorëve, familjet e të zhdukurve të UÇK, invalidët e UÇK, invalidë civilë të luftës, familjet e viktimate civile të luftës që janë në gjendje të rëndë ekonomike. Po ashtu e kam edhe një kërkesë që të liron edhe veteranët e luftës dhe ishe të burgosurit politikë që janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Pyetja e dytë është për drejtorin e shërbimeve publike? kur do të filloj ndërtimi i rrugës Rreti – Opterushë.

**Sinan Bajraktari** - Unë kam një pyetje drejtorin e shërbimeve publike? Për projektin e ujit të pijes për 5 fshatrat, Dobidol, Çifllak, Kramovik, Polluzhë dhe Guri i kuqë. Zyrtarisht është lëshuar uji për këto 5 fshatra në funde të vitit 2014, por në fshatin Guri i Kuqë dhe Polluzhë uji i pijes nuk funksionon fare dhe kjo vjen si pasojë e një defekti që e ka shkaktuar një fshatar, rasti është lajmëruar në kompani të Radoniqit 2 vite më parë po ashtu edhe në komunë, por deri më tanë asgjë nuk është bërë, unë kërkoj nga organet kompetente që të merë masa sa më shpejtë.

**Besnik Hoti** - Unë jam duke e ngritë një shqetësim të banorëve të fshatit Ratkovic, shtëpia e kulturës e fshatit Ratkovic është në një gjendje të mjerueshme, punëtori që është i caktuar për përkujdesje të këtij objekti nuk del fare në vendin e punës, gjendja e objektit është shumë e pavolitshëm dhe i mungon mirëmbajtja, po ashtu në muret e objektit ka lagështi dhe dëmtimet e fasadës së brendshme, ka edhe rrjedhje të ujit nga kulmi i objektit, gjithashtu edhe tualetet e këtij objekti janë në një gjendje katastrofale, objektit i mungojnë edhe rrëthojat nga jashtë, prandaj kërkoj nga institucionet që urgjentisht të vihet objekti nën përkujdesjen e komunës dhe aty të vihet një person adekuat që do të mirët me përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e objektit dhe po ashtu të jetë banor i fshatit Ratkovic.

**Florije Boshnjaku** - Unë kam disa kërkesa, komisionet që i formon ky kuvend nuk janë duke e sjellë raportet pas përfundimit të punës. Do i përmendi disa komisione që i ka formuar ky kuvend: Komisioni për ndryshime të statutit, Komisioni për ndarjen e Bursave, Komisioni për formimin e këshillave të fshatrave, ne duhet ta dimë dhe të kemi informatë se ku ka mbetur puna dhe si është kryer puna.

Po ashtu kam edhe një kërkesë që në mbledhjen tjetër të vije një propozim vendim që të formohen komitetet tjera në bazë të statutit që është në fuqi.

Po ashtu e kam edhe një shqetësim të qytetarëve që e kisha ngritë është që te tregu i qytetit në Rahovec tualetet janë në një gjendje me të vërtet të mjerueshme, aty afér shitet edhe bylmet ndërsa tualetet janë shumë të pista, kisha kërkuar që të mirët masa për mirëmbajtje të atyre.

**Muhamed Behra** - **Përgjigje:** Inspektori sanitari gjatë kontrollit inspektues me dt.08.05.2015 me nr.procesverbalit 14 Nr.159/2014 ka konstatuar se tualetet janë në gjendje jo të pastër te njëjtat nuk mirëmbahen ne treg. Në afërsi të tualeteve shiten gjera te tjera por jo ushqimet dhe bulmetet, sepse edhe gjate inspektimeve te me hershme shitëseve te bulmetit ju kemi tërheq vërejtjen qe mos te shesin afér tualeteve për shkaqe higjenike, gjithashtu shfrytëzuesit te tregut ju është bere vërejtje që përveç tregut te mirëmbaj edhe tualetet, ne do ta vëzhgojmë ketë situatë në të kundërtën do te ndërmarrim masa te parapara me ligjet ne fuqi.

**Arsim Kastrati** - Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike? A do të ketë ndonjë projekte për ndriçimin publikë për fshatin Drenoc.

Pyetje tjetër është kur do të filloj rruga tel Lagjja Zatriq pasi që është dalë në ministri tenderi qe 6 muaj ndërsa rruga ende nuk ka filluar.

**Azbi Gashi** – Kam një pyetje pér drejtorin e shërbimeve publike? I kam 2 kërkesa nga qytetarët që janë të protokolluar pikërisht pér drejtorin e shërbimeve publike dhe ende nuk i është kthyer përgjigja ende, dua ta di se ku qëndron problemi.

Pyetja tjetër është rreth trustit pensional të na jepe një sqarim drejtoria përkatëse se a janë duke na dalë shuma në trustë pensional apo vetëm është duke na u ndalë shuma ndërsa në trustë nuk po na figuron.

**Lulzim Sylejmani** – **Pergjigje ne pytjen e Azbi Gashi**, verifikimi e pagesave te trusti pér te gjithë ne e bëjmë me pranimin e listave te pagave nga MAPL-ja, ju lutem qe te kërkon raporte nga trusti ne mënyrë individuale dhe te vërtetohen pagesat e kontributave

**Kadri Dellova** – Kam një pyetje pér drejtorin e Kulturës dhe sportit? Në vitin 2013 kanë filluar të rregullohen disa fusha të futbollit ndërsa që dy vite nuk janë duke punuar, dua ta di se pse nuk janë duke punuar mos ju është ndërprerë kontrata. Flasë pér fushën e futbollit në Ratkovic, Radoste, Xérxe, Krushe dhe Apterushë. Pra dua një përgjigje nga drejtori se a do të filloj ndërtimi i fushave të futbollit.

**Osman Hasku** – **Përgjigje:** Projekti I rregullimit te fushave te futbollit ne fshatrat e lartcekura, gjate vitit 2014 është parapare te financohet nga mjetet, te cilat nuk janë aprovuar nga Kuvendi Komunal pér vitin buxhetor 2014, ndërsa pér vitin 2015 kemi parapare shumen e mjeteve prej 20000€, te cilat mjete I ka mare Thesari i shtetit per pagesën e faturave te mëhershme, prandaj pa siguruar mjete te nevojshme ne nuk mund te vazhdojmë, pér momentin, me ketë projekt. Dua te potencoq qe drejtoria pér kulture, rini dhe sport mbetet e përkushtuar pér përmbylljen e këtij projekti.

**Bahtjar Hoti** – Kam një pyetje pér Kryesuesin? Festa e dëshmorëve pér komunën e Rahovecit është data 12 maj dhe festohet çdo vite është i propozuar dhe i miratuar prej këtij kuvendi të komunës, unë kam një kërkesë se a do të kishte mundësi që të bëhet një pllakë modeste pikërisht aty ku është bërë lufta me 12 maj në Ratkovic.

**Selim Duraku** – Kam 2 pyetje pér drejtorin e shërbimeve publike? Fshati Krushës e Madhe do të organizojë me datën 24 maj pastrimin e mbeturinave që ndodhen në pjesën e sipërme të fshatit, neve na duhet një ndihmese nga komuna pér një ekskavator pér të hapim një gropë.

Pyetja tjetër është pér prockën që gjendet në mesë Krushës dhe Celinës kur do të filloj.

**Fatmir Iska** – Kam një pyetje pér drejtoreshën pér Arsim? Shkolla 7 shtatori në Rahovec është në një gjendje të mjerueshme, unë nuk e di se a ka qenë ta vizitojë atë shkollë nëse nuk ka qenë është mirë që të shkojë ta vizitojë dhe ta sheh se në çfarë gjendje është dhe të merë masa sa më shpejtë në përmasimin e gjendjes aktuale.

Pyetjen tjetër e kam pér drejtorin e shërbimeve publike? Rruga Vellezërit Haradinaj që lidhet me rrugën Gëzim Hamza – “Piktori” pjesa shtesë që ka filluar të ndërtohet është duke u ndërtuar pa kanalizim dhe pa ujësjellës nga ana e komunës. Po ashtu kjo rrugë a do të ndërtohet deri tek udhëkryqi apo do të ndërtohet deri tek rruga që lidhet tek Haxhijaha, dua një sqarim nga ana e drejtorit.

**Vjollca Vuçitërna** – drejtoreshë e DKA-së: **Përgjigje:** DKA është e vetëdijshme pér gjendjen jo të mirë të objektit të shkollës në fjalë. DKA realizon vizita të rregullta pér të mbikëqyrur procesin edukativo-arsimor, por edhe vështirësitë infrastrukturore me të cilat ballafaqohen shkollat tona. Besoj që ju si këshilltar jeni në dijeni me vështirësitë financiare dhe buxheteve të limituara të alokuara pér arsimin në komunën tonë. Megjithatë investimet sipas mundësive nuk janë ndalur dhe në këtë vazhdë edhe shkolla “7 Shtatori” ka qenë përfituese e këtyre investimeve si në nyje sanitare ashtu edhe në renovime të brendshme. Për informimin tuaj, momentalisht në këtë shkollë është në proces ngjyrosja e hapësirave të brendshme të kësaj shkolle. Ne i jemi drejtuar në vazhdimësi edhe MASHT-it pér pajisje me inventar shkollor por ende nuk kemi ndonjë përgjigje konkrete pér këtë çështje. Ne në vazhdimësi do të angazhohemi që të krijojmë kushte sa më të favorshme pér nxënësit e shkollave tona, por do të ishim mirënjohës që edhe komuniteti i nxënësit e të cilëve i gravitojnë shkollat respektive, të trokasim më shpesh në dyert e shkollave dhe të shtrijnë dorën drejtë përmirësimit të gjendjes së përgjithshme në shkolla. Ne kemi nevojë pér njeri- tjetrin në mënyrë që të avancojmë mirëqenien e përgjithshme, e në këtë segment shkollat duhet të kenë vëmendje të veçantë dhe me prioritet.

**Artan Zenuni** – Kam 2 pyetje pér drejtorin e shërbimeve publike? Rruga Hysni Duraku në vitin e kaluar është bërë traseja pér shtrimin e asfaltit dhe sipas drejtorit si të bëhet përmasimi i kohës do të shtrohet edhe me asfalt, dua ta di se kur do të filloj shtrimi i asfaltit të kësaj rruge.

Pyetjen tjetër e kam pér ndriçimin publikë në Krushën e Madhe? Kur do të mirët në menaxhim nga komuna ndriçimi publik.

**Rasim Fazliu** – Kam 2 pyetje pér drejtorin e shërbimeve publike? Kur do të filloj faza e dytë e e projektit të kullimit të tokave në Celinë.

Pyetja e tjetër është qe dy muaj dheu e ka zënë rrugën Fortesë – Celinë dhe ende nuk është hequr, dua ta di se kur do të hiqet ai dhe prej asaj rruge.

**Afrim Limani** – Kam 2 pyetje? E para është pér drejtorin e urbanizmit, në kuadër të projekteve pér investime është projekt i rregullimit të shtretërve të lumenjve, pyetja është se a është tenderi ky projekt dhe realizimi i këtij projektit a do të bëhet në bazë të shqyrtimit të ankesave që i kanë adresuar qytetarët.

Pyetja e dytë është për drejtorin e shërbimeve publike? E kisha lut drejton që të vije në fshatin Çifllak që të bëjë pastrimin e kanalizimit sepse është në gjendje të mjerueshme.

**Rukije Krasniqi** – Kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike? Çfarë masa keni mare për heqjen e pengesave të betonuara të shpeshta afër shtëpisë që janë bërë.

**Fehmi Hoxha** – Është ë vërtet që ekziston një kod rregullimi i shtretërve të lumenjve në komunën e Rahovecit, nga e gjitha kjo i kemi 3 lumenj që vazhdojnë punimet që janë të trashëguar nga qeverisja e kaluar, tek lumi Zaqishtë i kemi paraparë prej këtij kodi edhe 20.000.00 €, lumi Dullo nga ky kod janë paraparë 41.500.00 €, tek lumi i Fortes - Rimnik që janë bërë prerje të punimeve në bazë të para masës dhe para dhoga risë pasi që duhet të shpallet tenderi i ri sepse i ka kaluar afati ish operatorit ekonomik është ndarë nga ky kod edhe 28.500.00 € dhe nuk parashihet sivjet asnjë lumë të rregullohet arsyeha është mungesa e mjeteve materiale sepse na duhet diku afër 500.000.00 € për ti përfunduar këto që kanë filluar.

**Lulzim Sylejmani - Pergjigje per Ejup Kabashin:** Ligji nr. o3/L-204 i dt. 07.10.2010 nuk e liron nga pagesat as një kategori te tatimpaguesve, ju njoftoj se është ne procedurë plotësim ndryshimi i këtij ligji dhe besoj se këto kërkesa do te përfshihen ne ligjin e ri.

**Feim Fetoshi – Ejup Kabashi** pyeti se kur do të filloj rruga Reti – Opterushë.

**Përgjigje:** Ky projekt në 2013 është kryer një masë e madhe dhe tash na kanë mbetur vetëm obligime ndaj operatorit, për shkak të obligimeve që i kemi për ti paguar këtij operatori ne nuk pomundemi ti japim presion që ta kryej punën, por kemi mirëkuptim me operatorin që këtë rrugë ta asfaltoj sivjet.

**Sinan Bajraktari** pyeti për ujin e pijes për 5 fshatra.

**Përgjigje:** Ne më në fund kemi gjet rrugën e zgjidhjes së këtij problemi, para një jave është bërë një marrëveshje në mes kryetarit të komunës dhe drejtorit ekzekutiv të radoniqit që të kryhen ato punë të mbetur, dhe në bazë të kësaj marrëveshje ne e kemi ndarë edhe buxhetin për këtë punë, ne presim që komisioni i formuar nga kryetari dhe radoniqi të vije me një raport dhe pastaj ne do ti zotoj mjetet radoniqit e pastaj ata do të fillojnë menjëherë më ekzekutimin e atyre punëve të mbetur.

**Arsim Kastrati** pyeti rreth projekteve të ndriçimit publik.

**Përgjigje:** Ne i kemi ndarë diku rrëth 40.000.00 € për mirëmbajtje dhe zgjerim të ndriçimit publik i cili është në ri tenderim për shkak se nuk kanë ofertuar operatorët të mjaftueshëm sipas zyrës së prokurimit. Po ashtu kemi edhe një ofertë nga një kompani Daneze e cila ka bërë marrëveshje me Ministrin e Financave për kthim të investimeve, qeverisja Daneze na ofron që të bëjmë funksionalizimin komplet të ndriçimit publik ekzistues dhe zgjerimin me trupa efecientë dhe kthimin e mjeteve të bëhet për 5-6 vite dhe atë vetëm nga kursimi do të bëjmë. Sa i përket rrugës së Zatriqit ju e dini që Ministria e Infrastrukturës ë ka shpall tenderin për rrugën në Zatriq, për disa rrugë në Krushe dhe përrrugën që shkon ka "blatoja" në Rahovec. Kemi premtim nga ministria që këto rrugë do të kryhen.

**Azbi Gashi** pyeti për disa kërkesa që kanë ardhur nga fortesa dhe nuk ju është kthyer përgjigjja.

**Përgjigje:** Unë jam kureshtar ta di se cilat janë ato kërkesa po ashtu e ftoj Azbiun që të vije në zyre dhe të më tregoj, unë bëj presion të vazhdueshëm tek zyrtarët që kérkesat të i përgjigjen në afatin e caktuar me ligj.

**Selim Duraku** pyeti për mbeturinat ne Krushë,

**Përgjigje:** Ne si Drejtori e shërbimeve publike po presim që zyra e prokurimit të na sjellë kontratën me operatorin për intervenime emergjente, mendoj se kjo kontratë është dashur të kryhet që në mars por nuk e di se pse është shtyrë deri më tanë. Po ashtu atë ditë që do të më vijë kontrata në zyrën time pas dy ore do ta detyroj operatorin të del ta pastroj rrugën Fortes – Celin, kjo ishte përgjigje për Rasim Fazliun.

**Fatmir Iska** tha se rruga Vëllezërit Haradinaj nuk ka as kanalizim dhe as ujë.

**Përgjigje:** Kjo rrugë ka edhe kanalizim edhe ujë, ne kemi biseduar me personin i cili e ka qitë këtë kanalizim dhe ai është Selami Shehu i cili ka shpreh mirëkuptim që ai kanalizim me u zyrtarizu. Ne i kemi marrë të gjitha masat dhe do ti qesim pusetat dhe gypin përujë të pijes dhe presim që vetëm operatori ta filloj asfaltimin.

Mbledhja ka përfunduar në ora 13.15

Procesmbajtësi,  
Fahredin Sharku



-III- Nr. i prot 2105 Më 29.04.2015  
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC